

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR  
"Dervishaj Group" SHPK**

---



1

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Dervishaj Group"  
SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Dervishaj Group" SHPK  
KREU I

EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

Sot, më 17/08/2024 (dymjë e njëzet e kater), unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Dervishaj Group" SHPK

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "Dervishaj Group" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

NENI 2

SELIA

Selia e Shoqërise ndodhet në adresën: Tirane Njesia Administrative Nr 6, Rruga Teodor Keko Nr. 1880 181/1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Aktivitet tregtar i shitjes, riparimit dhe instalimit te materialeve hidraulike, elektrike, materiale per sistemet e ngrohjeve dhe ftohjes, Import dhe eksport, kryerjen dhe instalimin e sistemeve te ftohjes dhe ngohjes, ofrimin e sherbimeve hidraulike dhe elektrike dhe shitjen e edo artikulli qe sherben per ofrimin e ketyre sherbimeve dhe pa u limitur ne to. Aktivitet tregtar dhe çdo aktivitet tjeter që përban ligji. Çdo aktivitet tjeter që lidhet në mënyrë direkt dhe indirekt dhe që i shërben përbushjet së aktiviteteve si më lart.

**KREU II**

**KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

**NENI 5**

**KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku i cila zoteron 100 % (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatesisht:

- Z. Dine Dervishaj, shtetase shqiptare, i lindur në Corrush, dtl 07.06.1994, identifikuar me numër personal J40607090O, zotëruese e një kuote, me pjesëmarrje në përqindje 100 % me një kontribut prej 100.000 (Njëqind mijë) Lekë;

Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zoteron secili në kapitalin e Shoqërisë.

**NENI 6**

**KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT**

Në rast se një ortak apo një bashkëzotëruesh i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të janë të vetmit persona që do ti njihet titulli mbi kuotat nga Shoqëria; por asnjë nga keto parashikime nuk liron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga çdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit të Shoqërisë me disa trashëgimtarë të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet të caktojnë një përfaqësues të përbashkët.

Personi i cili fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku mund të zgjedhë të bëhet zotëruesh i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emrin e një personi tjeter të caktuar prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruesh i kuotës, ai njofton Shoqërine në lidhje me këtë zgjedhje.

Nëse personi i mësipërm zgjedh të kërkojë regjistrimin e kuotës në emr të një personi tjeter atëherë ai duhet ta kryejë atë nëpërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotës.

Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzon të zotëruesh i kuotës, duke përashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të



A handwritten signature in dark blue ink, appearing to read 'Dine Dervishaj'. To the right of the signature is the number '3'.

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Dervishaj Group"  
SHPK**

votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deni në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zotërues i kuotës.

**NENI 7  
ZMADHIMI I KAPITALIT**

Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.

Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjestim të drejtë me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.

Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i parashkuar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjera. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërisht të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

**NENI 8  
ZVOGËLIMI I KAPITALIT**

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.

Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

**KREU III**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**NENI 9**

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendlod mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesën e kapitalit që ai zoteron në Shoqëri.

Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjeter ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.

Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritet tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbal i përkatës.

Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e njoftuara Shoqërisë, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpëra datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.

Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të janë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet rë paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime rë vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zoterojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, përvèç rasteve rë

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTII "Dervishaj Group"  
SHPK**

parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të çdo ortaku pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zoteron më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

**KREU IV  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË  
NENI 10  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori zoteron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha akter që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.

Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera nën administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.

Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë:

- Znj. Aida Dervishaj, shtetase shqiptare, i lindur në Shiperi, dtd 17.05.1996, identifikuar me numër personal J65517081F,



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Dervishaj Group"  
SHPK**

**NENI 11**

**SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

**NENI 12**

**PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) i përfundon mandati;
- b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d) personi nuk gjzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e) mungon pa arsyé në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

**KREU V  
KONTROLLI FINANCIAR I SHOQËRISË,  
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENTI**

**NENI 13  
KONTROLLI FINANCIAR**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjisacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspert Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.

**NENI 14  
VITI FINANCIAR**

Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 15**

**BILANCI VJETOR**

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë dhe llogaritë vjetore.

Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.



7

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Dervishaj Group"  
SHPK**

**NENI 16**

**DIVIDENTI**

Pasi të jenë përbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividentët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividenti. Të gjithë dividentët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhes në të cilën paguhet dividenti.

**KREU VI**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM,  
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

**NENI 17**

**PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

**NENI 18**

**LIGJI I ZBATUESHËM**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në perputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e Shoqërise Tregtare.



AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I "Dervishaj Group"  
SHPK

NENI 19


ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë per objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palet nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje të njëjtë në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

DINE DERVISHAJ



9